

Përmbledhje

Ekonomia e Eurozonës në përballje me krizën ekonomike, sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it, ka shënuar rënie të aktivitetit ekonomik prej 15.0 përqind në TM2 2020. Përderisa aktiviteti ekonomik pritej të karakterizohej me dinamika të dobësuar edhe para ballafaqimit me pandeminë globale, rënia e evidentuar në tremujorin e parë dhe të dytë kryesisht i'u atribua ndikimit të masave të ndërmarrja për të parandaluar shpërndarjen e virusit COVID-19. Kriza e re ekonomike dhe sociale është reflektuar edhe në dinamikat e çmimeve në eurozonë, me ç'rast shkalla e shënuar e inflacionit ishte 0.2 përqind. Me krizë ekonomike në këtë periudhë është duke u ballafaquar edhe rajoni i Ballkanit Perëndimorë, që sipas parashikimeve të FMN-së të realizuara në prill 2020, pritet të karakterizohet me rënie prej 5.2 përqind në vitin 2020. Bazuar në vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM1 2020 shënoi rritje të ngadalësuar prej 1.3 përqind. Dinamikat e zhvillimeve makroekonomike ndryshuan kahje diametralisht në muajt vijues Prill dhe Maj, me shpalljen e gjendjes pandemike dhe ndërmarrjen e masave kufizuese nga Qeveria për të penguar përhapjen e virusit. Sipas ASK-së, aktiviteti ekonomik është karakterizuar me rënie prej 9.3 përqind në TM2 2020. Me rënie janë karakterizuar kryesisht kreditë e reja, eksporti i shërbimeve por edhe shpenzimeve kapitale të qeverisë, ndërsa pavarësisht krizës së pandemisë, remitencat, IHD-të por edhe eksporti i mallrave kanë shënuar rritje. Çmimet e konsumit shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.6 përqind deri në qershor 2020, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të transportit, rekreacionit, veshmbathjes, por edhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë shënoi rënie prej 0.2 përqind.

Spektori fiskal deri qershor 2020 u karakterizua me rënie të të hyrave buxhetore prej 10.9 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 2.2 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 111.5 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 16.2 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 18.2 përqind, nga 16.5 përqind sa ishte në TM2 2019.

Asetet e sistemit financiar u rritën për 238.2 milionë euro në TM2 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe sektorit pensional. Rritja e aseteve të sektorit bankar i atribuohet kryesisht nivelit të lartë të depozitave të arkëtuara në këtë tremujor, që njëherësh paraqet dhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar. Kurse, zgjerimi i aseteve të sektorit pensional erdhi si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet. Spektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të aktivitetit. Niveli i primeve dhe i dëmeve shënoi rënie, ndërsa profiti i realizuar ishte më i lartë. Në të njëjtën periudhë, sektori mikrofinanciar shënoi rritje më të ngadalësuar të aktivitetit, nivel të kënaqshëm të fitimeve të realizuara dhe nivel të ulët të kredive me probleme.

Spektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 19.0 përqind, që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të deficitit të mallrave si dhe rritjes së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv i shërbimeve ishte dukshëm më i ulët. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind, ndërsa IHD-të shënuan rritje prej 48.7 përqind deri në qershor 2020.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	6
Sektori Fiskal -----	7
Sektori Financiar -----	8
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë -----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	06
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj -----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	09
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat -----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve -----	12
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në Ballkanin Perëndimor -----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	14

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it, aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka shënuar rënie prej 15.0 përqind në TM2 2020 (figura 1). Rënia e aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë dhe të dytë paraqesin tkurrjen më të thellë të aktivitetit ekonomik që nga viti 1995 kur Eurostat-i filloi të publikojë këtë seri kohore.



Burimi: Eurostat (2020)

Masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së COVID-19 që nga muaji mars u përkthyen në rënie të aktivitetit në pothuajse të gjitha vendet anëtare të Eurozonës. Ndërsa, sipas sektorëve, humbjet më të mëdha rezultojnë të jenë shënuar tek tregtia me pakicë, transporti, si dhe aktivitetet e artit, argëtimit dhe rekreacionit. Për vitin 2020, kryesisht si pasojë e krizës shëndetësore, ekonomike dhe sociale që ka shkaktuar pandemia, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka parashikuar rënie ekonomike prej 8.7 përqind.

Rënia e aktivitetit ekonomik u përkthye në dinamika të dobëta edhe në nivelin e çmimeve në eurozonë. Në TM2 2020, shkalla mesatare e Indeksit të

Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Eurozonë ishte 0.2 përqind (1.4 përqind në TM2 2019) (figura 1).

Me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë dhe asistimit në rikuperim ekonomik përmes mbështetjes së financimit të ekonomisë reale (veçanërisht bizneseve dhe ekonomive familjare), në qershor 2020, BQE morri vendim lidhur me programin e ri të lehtësimit sasior. Ky program, i emërtuar si “Programi për Blerje Emergjente të Aseteve në Pandemi” u rritë në 1.35 miliardë euro, dhe pritet të zgjatë së paku deri në fund të qershorit 2021.

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.5 përqind, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.2 përqind. Në anën tjetër, me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat në sistemin bankar, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 17.5 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 6.2 përqind.

Edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, aktiviteti ekonomik në TM1 2020¹ është ngadalësuar në 1.3 përqind, nga 3.2 përqind sa ishte në TM1 2019 (tabela 1).

¹ Të dhënat për TM2 2020 nuk janë publikuar ende.

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në B. Perëndimor

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1
Serbia	5.0	5.0	4.2	3.5	2.6	2.9	4.8	6.2	5.0
Mali i Zi	4.8	5.2	5.3	4.9	3.0	3.2	4.7	3.1	2.7
Kosova	2.9	4.4	3.8	4.1	4.2	4.1	4.4	3.9	1.3
Maqedonia e Veriut	0.9	3.0	3.0	3.7	3.8	3.4	3.6	3.4	0.2
Shqipëria	4.2	4.4	4.6	3.1	2.4	2.6	4.2	-0.1	-2.5

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Parashikimet e realizuara në prill 2020 nga FMN-ja sugjeronin për rënie të aktivitetit ekonomik në rajon për mesatarisht 5.2 përqind.

Norma mesatare e inflacionit në TM2 2020 ishte 0.5 përqind, që është normë më e ulët krahasuar me 1.8 përqind sa ishte në TM2 2019. Normat më të ulëta të inflacionit ishin evidente pothuajse në të gjitha vendet e rajonit (tabela 2). Ky trend i inflacionit pritet të vazhdoj edhe në tremujorët në vazhdim dhe sipas FMN-së, norma mesatare e inflacionit në vitin 2020 pritet të jetë 0.7 përqind.

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në B. Perëndimor

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2
Kosova	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1	0.2
Mali i Zi	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5	-1.1
Maqedonia e Veriut	2.6	2.3	2.2	1.9	1.9	1.4	0.1	-0.5	-0.1	0.3
Serbia	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4	2.3	1.3	1.4	1.8	1.0
Shqipëria	1.9	2.2	2.2	1.8	1.6	1.4	1.4	1.3	1.6	1.9

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, edhe vendet e Ballkanit Perëndimorë sikurse vendet e Eurozonës, shënuan rritje të aktivitetit kreditues dhe depozitues. Kreditimi shënoi rritje prej 7.1 përqind, që është normë më e lartë e rritjes krahasuar me normën prej 6.2 përqind në TM2 2019. Vendet të cilat shënuan normat më të larta të rritjes ishin Serbia dhe Maqedonia e Veriut (13.4 përqind përkatësisht 8.7 përqind), pastaj Kosova dhe Shqipëria (6.4 përqind përkatësisht 6.2 përqind), ndërsa Mali i Zi dhe Bosnja

e Hercegovina shënuan normat më të ulëta të rritjes së kreditimit (5.0 përqind përkatësisht 2.6 përqind). Depozitat shënuan rritje akoma më të lartë, duke arritur normën mesatare prej 8.4 përqind në nivel të rajonit (6.8 përqind rritje në TM2 2019). Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Serbi dhe Kosovë (17.9 përqind përkatësisht 14.0 përqind), pasuar nga Maqedonia e Veriut (8.1 përqind), Shqipëria (5.4 përqind), Bosnja e Hercegovina (4.7 përqind) dhe Mali i Zi (0.3 përqind).


Gjatë TM2 2020, euro është zhvlerësuar ndaj frankës zvicerane dhe dollarit amerikan (5.8 përqind përkatësisht 2.1 përqind), ndërsa është vlerësuar ndaj valutave tjera: 14.6 përqind ndaj lirës turke, 2.2 përqind ndaj kunës kroate, 1.4 përqind ndaj sterlinës britanike, 1.1 përqind ndaj lekut shqiptar dhe 0.3 përqind ndaj denarit maqedonas.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave të ASK-së, aktiviteti ekonomik është ngadalësuar në 1.3 përqind në TM1 2020, nga 4.2 përqind sa ishte në TM1 2019. Ky ngadalësim i aktivitetit ekonomik i'u atribua kryesisht masave kufizuese mbi lëvizjen e qytetarëve dhe mbylljen e aktiviteteve të caktuara ekonomike, me shpalljen e pandemisë COVID-19 në dy javët e fundit të TM1 2020 dhe gjatë TM2 2020. Vlerësimet zyrtare të ASK-së për BPV-në e TM2 2020 sugjerojnë për rënie të aktivitetit ekonomik prej 9.3 përqind. Në rënien e aktivitetit ekonomik vlerësohet të kenë kontribuar komponenta e investimeve, që vlerësohet të kenë kontribuar negativisht me -14.3 pikë përqindje. Në anën tjetër, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit dhe eksporteve neto me 4.1 përkatësisht 1.0 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Vlerësimet e ASK-së për rënie ekonomike në TM2 2019 mbështeten edhe nga rënia e kredive të reja, si atyre konsumuese ashtu edhe atyre investuese, rënies së eksportit të shërbimeve por edhe rënies së shpenzimeve kapitale të qeverisë. Indikacioni i rënies

së kërkesës së brendshme është edhe rënia e importit të mallrave prej 18.9 përqind në TM2 2020. Në anën tjetër, disa nga burimet e jashtme të financimit (remitencat dhe IHD-të), por edhe eksporti i mallrave, shënuan rritje gjatë kësaj periudhe. Në baza sektoriale, rënie shënuan sektori i ndërtimtarisë (-47.1 përqind), tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore (-24.4 përqind), aktivitetet profesionale dhe administrative (-16.4 përqind), aktivitetet financiare dhe të sigurimit (-6.7 përqind), etj., ndërsa rritje shënuan sektori i industrisë nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, furnizimi me ujë (19.8 përqind), informacioni dhe komunikacioni (29.6 përqind), aktivitete të pasurive të paluajtshme (4.3 përqind), etj.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje të ngadalësuar prej 0.6 përqind deri në qershor 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kur ishte shënuar rritje prej 3.2 përqind (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2020)

Rritja më e lartë është shënuar tek çmimet e shërbimeve shëndetësore, hotelarisë, orendive shtëpiake, si dhe mjeteve të komunikimit. Kategoritë

tjera shënuan rritje të ngadalësuar gjegjësisht rënie të çmimeve. Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rritje dukshëm më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, mirëpo, për shkak të peshës së madhe në shportën e konsumatorit kosovarë, kontribuuan pozitivisht me 0.84 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin

Përshkrimi	Peshat 2020	Norma e inflacionit	Kontributi
GJITHSEJ	100.0%	0.6	0.63
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.1%	2.0	0.84
Pijet alkoolike dhe duhani	5.7%	0.3	0.02
Veshmbathja	4.1%	-0.6	-0.02
Energjia	7.7%	0.2	0.01
Orenditë	7.6%	1.3	0.10
Shëndetësia	2.1%	4.8	0.10
Transporti	15.7%	-4.3	-0.67
Komunikimi	3.8%	1.0	0.03
Rekreacioni	4.4%	-0.5	-0.02
Arsimi	1.0%	0.1	0.00
Hoteleria	3.2%	2.5	0.08
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.5%	3.8	0.17

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), dhe përjashtimi i këtyre komponentëve bënë që inflacioni bazë të jetë më stabil (figura 3). Inflacioni bazë rezultoi të jetë -0.2 përqind, apo 0.9 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve të importit, të cilat deri në qershor 2020 shënuan rënie mesatare prej 2.1 përqind (3.7 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2019). Përveç çmimeve të

importit me rënie prej 0.9 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rënies ishte më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në qershor 2020 arritën vlerën neto prej 760.3 milionë euro (rënie vjetore prej 10.9 përqind), ndërsa shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 871.8 milionë euro (rritje vjetore prej 2.2 përqind). Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 111.5 milionë euro.

Pandemia COVID-19 ka ndikuar në rënien e kërkesës vendore, duke ndikuar në rënien e të hyrave tatimore direkte për 14.1 përqind deri në qershor 2020. Të gjitha kategoritë e të hyrave tatimore direkte shënuan rënie. Tatimi në të ardhurat e korporatave dhe tatimi në të ardhurat personale, si dy kategoritë kryesore të të hyrave tatimore direkte, shënuan rënie prej 14.9 përqind përkatësisht 9.0 përqind. Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht edhe importin e mallrave, duke shkaktuar rënie prej 9.5 përqind në të hyrat tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 569.1 milionë euro dhe përbëjnë 74.9 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore. Rënie edhe më e lartë e të hyrave buxhetore është shënuar tek të hyrat jo-tatimore, të cilat arritën vlerën prej 76.4 milionë euro, që është për 22.3 përqind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.

Shpenzimet buxhetore u karakterizuan me ngadalësim të rritjes, kryesisht si pasojë e vonesave në aprovimin e Buxhetit për vitin 2020 nga ana e Kuvendit të Kosovës por edhe të ndikimit të pandemisë COVID-19. Kategoria kryesore që kontribuoi në ngadalësimin e

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

rritjes së shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale, të cilat shënuan vlerën prej 92.5 milionë euro apo 23.1 përqind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Me rënie prej 3.2 përqind u karakterizuan edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale), të cilat arritën nivelin prej 110.3 milionë euro. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 7.1 përqind dhe arritën vlerën 326.4 milionë euro, përderisa subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 16.4 përqind dhe arritën vlerën 348.3 milionë euro.

Borxhi publik në TM2 2020 ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 16.2 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 18.2 përqind nga 16.5 përqind sa ishte në TM2 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 22.5 përqind (që ka arritur në 884.5 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka arritur në 429.6 milionë euro gjegjësisht është rritur për 4.9 përqind kundrejt TM2 2019. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 32.7 përqind, nga 36.2 përqind sa ishte në TM2 2019. Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 18.2 e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës dhe

planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

Sektori Financiar⁴

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 238.2 milionë euro, duke reflektuar kryesisht rritjen e aseteve të sektorit bankar dhe sektorit pensional. Zgjerimi i aseteve të sektori bankar erdhi kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të depozitave të arkëtuara në këtë tremujor, që njëkohësisht paraqet dhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar. Kurse, zgjerimi i aseteve të sektorit pensional i'u atribuua kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe. Sektori bankar shënoi fitim neto në vlerë prej 17.9 milionë euro në këtë tremujor, që është më i ulët për 3.4 milionë euro krahasuar me TM2 2019, kryesisht si pasojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave të sektorit. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera të kënaqshme. Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore dhe mbulueshmëri optimale me provizione. Indikatorët e solvencës dhe likuiditetit vazhdojnë të jenë mbi nivelin minimal të rekomanduar me rregullore.

Sektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ndikuar nga kthimi pozitiv nga investimet në TM2 2020 (duke rikuperuar deri në një masë humbjet e shkaktuara gjatë TM1 2020) dhe kontributet e arkëtuara, megjithëse në masë më të ulët kundrejt tremujorëve paraprak, indikacion i efekteve negative të pandemisë Covid-19 në ekonomi.

⁴ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM2 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të arkëtuara dhe i dëmeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe shënoi rënie, e që ndërlidhet me efektin e pandemisë Covid-19. Sektori i sigurimeve gjatë TM2 2020 shënoi profit në nivel të lartë krahasuar me rezultatet negative financiare në tremujorin e dytë të vitit të kaluar.

Sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të aktivitetit gjatë TM2 2020, por që rritja është dukshëm më e ngadalësuar se periudhat paraprake. Megjithë efektet negative të pandemisë, sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë performancë të kënaqshme dhe cilësi të mirë të portfolios kreditore.


Në TM2 2020, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë mjaftë të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e borxhit të emtuar nga Qeveria e Kosovës gjatë TM2 2020 arriti vlerën prej 162.4 milionë euro. Kërkesa për të investuar në letrat me vlerë ka tejkaluar vazhdimisht kërkesën e qeverisë së Kosovës.

Sektori i Jashtëm

Deri në qershor 2020, deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 233.3 milionë euro, që është për 19.0 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2019. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet zvogëlimit të deficitit të mallrave si dhe rritjes së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv i shërbimeve ishte dukshëm më i ulët (figura 4).

Deficiti në llogarinë e mallrave⁵ arriti vlerën prej 1.2 miliardë euro deri në qershor 2020, që paraqet një rënie vjetore prej 12.6 përqind (3.4 përqind rritje në periudhën e njëjtë 2019). Kjo rënie e deficitit të mallrave i atribuohet kryesisht rritjes më të lartë të eksportit të mallrave dhe rënies po ashtu të lartë të importit..


Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Vlera e eksportit të mallrave arriti në 213.1 milionë euro, një rritje e konsiderueshme vjetore prej 19.7 përqind (5.3 përqind rritje në qershor 2019) (figura 5).

Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK (2020)

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, perimet, makineritë dhe pajisjet elektrike, si dhe ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani. Në anën tjetër, rënie shënoi eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (figura 6).


Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2020)

Vlera e importit të mallrave arriti në 1.5 miliardë euro, që paraqet rënie prej 9.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në rënieën e importit ka ndikuar kryesisht niveli më i ulët i importit të produkteve minerale (kryesisht derivate të naftës) dhe metaleve bazë, kategori të cilat kanë shënuar rënie të çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Me rënie të theksuar është karakterizuar edhe importi i mjeteve të transportit si dhe tekstili dhe artikujt e tekstilit. Në anën tjetër, importi i ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit si dhe importi i perimeve ka shënuar rritje (figura 7).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 141.2 milionë euro deri në qershor 2020, një rënie vjetore prej 51.9 përqind. Vlera e shërbimeve të eksportuara rezulton të ketë qenë 382.8 milionë euro apo 34.8 përqind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Eksporti i shërbimeve ka një pjesëmarrje të lartë në BPV (24 përqind në vitin 2019) dhe përbëhet kryesisht nga eksporti i shërbimeve të udhëtimit (79 përqind e gjithsej eksportit të shërbimeve ishte eksport i shërbimeve të udhëtimit në vitin 2019), që janë kryesisht shpenzime të diasporës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Duke pasur parasysh faktin se rreth gjysma e eksportit të shërbimeve të udhëtimit realizohet në tremujorin e tretë si dhe masave kufizuese që ndërmorën qeveritë e vendeve ku janë të koncentruar diaspora kosovare, vlerësohet se në TM3 2020 rënia e eksportit të shërbimeve ishte akoma më e lartë krahasuar me tremujorin paraprak. Rrjedhimisht, rënia e eksportit të shërbimeve pritet të jetë njëri prej kanaleve kryesore të transmetimit të krizës. Në anën tjetër, vlera e shërbimeve të importuara ishte 241.6 milionë euro apo 17.5 përqind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Sikurse tek eksporti i shërbimeve edhe tek importi, rënie kanë shënuar shërbimet e udhëtimit, shërbimet e transportit si dhe shërbimet e ndërtimit, që kryesisht ndërlidhen me pasojat e masave kufizuese të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit korona.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi vlerën prej 98.3 milionë euro, që paraqet një rritje të lehtë prej 1.7 përqind. Në anën tjetër, bilanci i të ardhurave dytësore arriti në 665.8 milionë euro, që është për 6.9 përqind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Remitencat e pranua në Kosovë shënuan vlerën prej 434.9 milionë euro deri në qershor 2020, që paraqet rritje për 7.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë 2019 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)


Remitencat që pranohen në Kosovë vazhdojnë të vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga u dërguan 43.1 përqind përkatësisht 24.3 përqind e gjithsej remitencave në TM2 2020. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 5.4 përqind e gjithsej remitencave të pranua në Kosovë. Përkundër faktit se edhe vendet ku janë të koncentruar diaspora kosovare janë goditur shumë nga kriza e pandemisë, remitencat kanë shënuar përsheptim të rritjes. Rritja e remitencave ka qenë dyshifrore gjatë gjithë periudhës, me përjashtim të muajit mars dhe prill kur shënuan rënie. Dërgesat e remitencave përmes operatorëve që transferojnë para kanë shënuar rritje për 46.3 përqind deri në qershor

ndërsa remitencat që dërgohen përmes bankave kanë shënuar rritje për 19.0 përqind. Në anën tjetër, duke pasur parasysh mbylljen e kufirit si dhe kufizimeve të tjera, remitencat që vijnë përmes “kanalit jo-formal” kanë shënuar rënie prej 52.3 përqind deri në qershor 2020. Ky trend i rritjes së remitencave pritet të vazhdoj edhe në muajt vijues (vetëm në muajin korrik rritja e remitencave ishte 23.9 përqind).

Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënoi vlerën prej -284.1 milionë euro (-145.1 milionë euro deri në qershor 2019). Kjo rritje e bilancit negativ në llogarinë financiare ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të investimeve jashtë Kosovës, kryesisht investimet portfolio. Edhe detyrimet në kuadër të llogarisë financiare shënuan një rritje (25.4 përqind). Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 164.7 milionë euro që janë për 48.7 përqind më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Ky nivel i rritjes së IHD-ve i atribuohet edhe faktit se gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë nuk kanë shpërndarë dividendë për aksionarët e tyre, indikacion ky se kriza mund të ketë goditur edhe IHD-të përkundër rritjes së tyre. Për më tepër rritja e IHD-ve është shënuar në muajt janar dhe qershor, përderisa gjatë muajve të tjerë kanë shënuar rënie.

Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 128.4 milionë euro dhe shënoi rritje prej 56.5 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan rritje vjetore prej 26.3 përqind dhe arritën vlerën prej 36.3 milionë euro (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektorët e shërbimeve financiare, energjetikës, si dhe minierave, ndërsa sektori patundshmërive si dhe sektori i ndërtimitarisë shënuan rënie.

Sa i përket origjinës së IHD-ve, Shqipëria paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD deri në qershor 2020 (32.2 milionë euro), pasuar nga Gjermania (29.2 milionë euro), Hungaria (25.8 milionë euro), Zvicra (25.4 milionë euro), SHBA (13.1 milionë euro), etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 31, TM2 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/media/5373/hck-mars-2020-shqip.pdf>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/media/5438/indeksi-i-çmimeve-te-prodhimit-tm1-2020-shqip.pdf>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/media/5432/indeksi-i-çmimeve-të-importit-içimp-tm1-2020.pdf>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/media/5391/rep-stat-mbi-ndër-ekono-në-kosovë-tm1-2019.pdf>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/media/5382/statistikat-e-tregtisë-së-jashtme-stj-mars-2020.pdf>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2020/01/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2019	Qershor 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	3,245.3	3,073.9
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.2%	0.6%
Çmimet e konsumit (fundi i periudhës)	2.9%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	853.5	760.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	853.2	871.8
Bilanci primar (në milionë euro)	0.3	-111.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,666.4	7,412.2
prej të cilave: Bankat	4,303.4	4,849.0
Kredi	2,940.0	3,127.4
Depozita	3,425.3	3,903.2
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.34%	6.26%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.28%	1.54%
Hendeku i normës së interesit	5.1%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-294.3	-227.8
prej të cilave: remitencat e pranuar	405.6	434.9
Llogaria financiare	-145.1	-284.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	110.8	164.7
Investimet portfolio, net	-31.7	-388.9
Investimet tjera, net	-260.9	214.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-462.4	-709.7
Asetet	4,912.3	5,076.3
Detyrimet	5,374.7	5,786.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,155.0	2,273.0
Borxhi i jashtëm privat	1,663.2	1,754.4
Borxhi i jashtëm publik	491.7	518.6

Burimi:

1/ ASK (2020).

2/ MF (2020).

3/ BQK (2020).

